

## Hapet thirrja për bursa studimi për studentët e UMT, në Universitetin Turibës në Letoni, në kuadër të programit Erasmus +.

### Mobiliteti dhe kohëzgjatja e bursave:

Studentët do të studiojnë semestrin e parë të vitit akademik 2026-2027 në Universitetin e Turibës në Letoni.

### Kush mund të aplikojë:

Mund të aplikojnë studentët e UMT të cilët gjatë vitit akademik 2026-2027 do të jenë në vitin e dytë dhe të tretë, të ciklit bachelor si edhe studentët e vitit të parë dhe të dytë master, në fakultetet:

- Fakulteti i Ekonomisë (Bachelor dhe Master)

Ju mund të gjeni listën e lëndëve që zhvillohen në anglisht në universitetin pritës për semestrin e parë duke shfletuar guiden studentore.

### Gjuha e mësimdhënies:

Mësimdhënia do të jetë në gjuhën angleze.

### Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor për studentët (800 EUR në muaj);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës).

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni në këtë link:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

### Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- Kopje e pasaportës
- Vërtetim dhe Listë notash të ciklit aktual të studimit;
- CV
- Foto e skanuar në madhësi pasaporte (me cilësi të mirë – 300 pikselë; madhësia – 3\*4 cm; formati i skedarit - .jpg);
- Learning Agreement

*\* Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Before the mobility. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin Metropolitan Tirana kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

*KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin e Turibes në Letoni lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë të vitit akademik 2026/2027 në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të jepni provim lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Metropolitan Tirana.*

*Dokumenti “Learning Agreement” tek seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti dhe më pas në seksionin “sending university” firmoset nga Përgjegjësi i Departamentit në UMT.*

Afati për aplikim: **5 Maj, 2026.**

Për të aplikuar ju lutemi të dorëzoni dokumentet të skanuara me e-mail në adresën [iro-projects@umt.edu.al](mailto:iro-projects@umt.edu.al) ose dorazi në Drejtorinë e Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Universitetin Metropolitan Tirana.

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: [iro-projects@umt.edu.al](mailto:iro-projects@umt.edu.al)

***UMT ju uron shumë suksese në aplikimin tuaj!***